



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 22 dhe nenit 38, të Ligjit Nr-04/L-110, për Ndërtimit, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-18/2012”, e konform dispozitave ligjore të Udhëzimit administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës dhe nenit 15, paragrafi 1, shkronja (b), nenit 28 paragrafi 2, shkronja (f) dhe 29, paragrafi 2, shkronja (d), të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 29.03.2019, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Suharekë, cakton taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit për kategorinë e I dhe II-të, lejes së rrënitit dhe tarifën rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës.

Neni 2

- 2.1 Taksa administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit kategoria e I-rë (T_{AD}) do të jetë **2.40€/m²** (dy euro e katër dhjetë centë për metër katror) dhe llogaritet për tërë territorin e Komunës.**
- 2.2 Taksa administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit kategoria e II-rë (T_{AD}) do të jetë **2.80€/m²** (dy euro e tetëdhjetë centë për metër katror) dhe llogaritet për tërë territorin e Komunës.**
- 2.3 Taksa administrative për lëshimin e lejes së rrënitit (T_{AD}) do të jetë **1.00€/m²** (një euro për metër katror) dhe llogaritet për tërë territorin e Komunës.**
- 2.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit të Infrastrukturës do të aplikohen sipas, Shtojcës 7, të Udhëzimit administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, (T_{RRI}) do të jetë **120.62€** për kokë banori, e kthyer në njësi **m²** është **1.80€/m²** (një euro e tetëdhjetë cent për metër katror).**
- 2.5 Për taksa administrative në llogari hynë sipërfaqja bruto e pllakave të objektit (etazhet), ndërsa për tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës, hynë sipërfaqja neto e banimit për kokë banori.**
- 2.5 Për objekte që nuk maten me metër katrorë aplikohen formulat e caktuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, me (vendimi me numër, Nr-043/2013 i datës, 15.03.2013).**

- 2.6 Punët rreth llogaritjes së pagesës së taksave e bënë Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim e Komunës së Suharekës në bazë të dokumentacionit teknik të parashtruar nga aplikuesi.
- 2.7 **Taksa administrative për leje ndërtimore për kategoritë I dhe II, leje rrënimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës,** janë llogaritur sipas Udhëzimit administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës.

Neni 3

- 3.1 Njoftimi për pagesë duhet të përmbajë të dhënat bazë nga projekti, procedurën e llogaritjes, për të cilën është dhënë pëlqimi, llogarinë bankare të Komunës dhe afatin për pagesën e taksave.
- 3.2 Afati për pagesë fillon nga dita e pranimit të njoftimit dhe nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë për kategorinë e I-rë dhe 30 ditë për kategorinë e II-të.
- 3.3 Leja ndërtimore nuk lëshohet pa dëshminë e pagesës së taksave konform njoftimit për pagesë.
- 3.4 Nëse pagesa nuk bëhet brenda afatit të paraparë, ndërpritet procedura e lëshimit të lejes ndërtimore me arsyetim se pala ka heq dorë nga kërkesa për leje ndërtimi.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr. 01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendim për aprovim të taksave administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës me numër, 01-Nr-16-9367, i datës 31.12.2014.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-21653
Me datë 29.03.2019

